



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201300786/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** Rekomandohet *"Përmirësimi i pikes 3, të nenit 121, të Ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", për veprimtarinë e punonjësve të Policisë të Strukturave Speciale Operacionale"*.

**Drejtuar :** Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore,  
Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut  
Z. Fatmir XHAFA

Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare  
Z. Spartak BRAHO

**KUVENDI**

**TIRANË**

*Të nderuar Zotërinj,*

Avokati i Popullit gjatë veprimtarisë së punës për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve në vite, ka patur raste të shqetësimeve të personave të ndryshëm, të dënuar, deputetë, etj, të cilët kanë ngritur pretendimin se punonjës të strukturave të Forcave Speciale Operacionale gjatë kryerjes së operacioneve kanë ushtruar dhunë fizike apo përdorur fjalë fyese në cënim të dinjitetit njerëzor të tyre. Mandej, në rastet kur Prokuroria ka filluar hetimet, ajo është penguar për kryerjen e gjithanshme të tyre, pasi Policia nuk ka ndihmuar për dhënien e gjeneraliteteve të punonjësve të policisë të dyshuar për kryerjen e veprave penale si dhe vënien e tyre në dispozicion të organit procedues, me arsyetimin e ruajtjes së fshehtësisë dhe identitetit të punonjësve të strukturave policore.

Avokati i popullit e ka ndjekur me shqetësim këtë fenomen dhe për rastet e trajtuara, pasi ka kryer hetime të pavarura administrative ka rekomanduar fillimin e hetimeve për veprën penale të *"Kryerjes së veprimeve arbitrare"*, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal, ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer veprimet e kundërligjshme.

I tillë ka qënë rasti i katër shtetasve të dënuar, ngjarje e ndodhur në vitin 2002, të cilët po transportoheshin prej FNSH, nga Komisariati i Policisë Durrës në Burgun 302 Tiranë. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas fillimit të hetimit në përfundim të tyre, ka vendosur pushimin e hetimit të procedimit penal. Pas studimit të këtij vendimi është konstatuar se ai ishte i padrejtë dhe i pabazuar dhe për këtë, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr.938 e vitit 2002. Prokurori i Përgjithshëm në përgjigjen e tij drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit ndërmjet të tjerave ka arsyetuar se: *“Shfuqizimi i këtij vendimi pushimi bëhet i pamundur për arsye se sipas nenit 4 të ligjit nr.8292, datë 25.02.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë” (i shfuqizuar) i cili thotë “Çdo pjestari të njërive speciale dhe të ndërhyrjes së shpejtë, i garantohet fshehtësia e identitetit personal, duke i përfshirë këto forca dhe në rastet e shoqërimeve”.*

Rast tjetër i marrë në shqyrtim nga Institucioni i Avokatit të Popullit ka qënë ai i vitit 2001, ankesa e shtetasit Azgan Haklaj, ish deputet i Kuvendit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte nxjerrë urdhër për ndalimin e tij, për veprën penale të *“Organizimit të grumbullimeve dhe manifestimeve të paligjshme, me pjesëmarrjen e personave të armatosur”*. Ekzekutimi i urdhërit të Prokurorisë është realizuar nga Forcat Speciale “Renea”, të cilat gjatë shoqërimit kanë ushtruar dhunë fizike duke e keqtrajtuar shtetasin Azgan Aklaj. Organi i Prokurorisë i ka kërkuar Ministrisë së Rendit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të informonte për punonjësit që kanë marrë pjesë në ekzekutimin e urdhërit të ndalimit, por Drejtoria e Policisë nuk ka krijuar mundësinë e marrjes në pyetje të tyre, referuar nenit 4 të ligjit të mësipërm *“Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”*.

Në këto rrethana Avokati i Popullit i ka kërkuar Kuvendit përmirësimin e nenit 4 dhe megjithë përsëritjen e rekomandimit, ai nuk është marrë në konsideratë. Ligji nr.8292, datë 25.02.1998 *“Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”* është shfuqizuar, por përmbajtja e nenit 4 të tij, nuk ka asnjë ndryshim me përmbajtjen e pikës 3, të nenit 121, të ligjit aktual nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*, në të cilin thuhet se: *“Punonjësve të strukturave operacionale u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale”*.

Konstatohet se edhe në Projektligjin *“Për Policinë e Shtetit”* të vitit 2014, neni 134 që bën fjalë për *“Kryerjen e operacioneve speciale”*, nuk ka asnjë ndryshim tek të gjitha pikat e tij, dhe sidomos pikës 3, e cila në përmbajtje është e njëjtë me pikën 3, të nenit 121, të ligjit ekzistues *“Për Policinë e Shtetit”*.

Duke shprehur respektin për ligjvënësin, për bërjen dhe miratimin e këtij ligji, për rolin dhe rëndësinë e Strukturave të Forcave Speciale Operacionale përsa i përket misionit në kryerjen e operacioneve të sigurisë së veçantë dhe zgjidhjen e situatave që nuk mund të zgjidhen nga shërbimet e tjera të policisë, ekzekutimi i të cilave kërkon persona të përgatitur, duhet të theksojmë edhe faktin se neni i sipërcituar, përbën një dispozitë që krijon premisa për shkelje të rëndë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ky nen vjen ndesh me të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve qofshin dhe të dënuar, të sanksionuara në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës të

Shqipërisë: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit”*, dhe nenin 25 të saj ku thuhet: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”*.

Po ashtu dhe në nenin 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është parashikuar e drejta për të mos iu nënshtruar torturave ose dënimeve çnjerëzore degraduese.

Në parimet themelore të së drejtës penale përcaktohet qartë se kush kryen veprë penale, krim apo kundravajtje mban përgjegjësi penale, kur ka mbushur moshën respektivisht 14 dhe 16 vjeç (neni 12 i Kodit Penal). Për rrjedhojë Kodi Penal nuk bën asnjë përjashtim nga rregulli për punonjësit e strukturave të Forcave Speciale Operacionale, në rast se prej tyre mund të kryhet një veprë penale gjatë ushtrimit të detyrës.

Argumentimin tonë e mbështesim me faktin se punonjësit e strukturave të Forcave Speciale Operacionale, gjatë veprimtarisë së punës së tyre nuk janë të imunizuara nga veprime ose mosveprime që përbëjnë tejkalim të kompetencave që përcakton ligji në fjalë, pra kur edhe ata mund të kryejnë veprime të kundërligjshme të dukshme apo të fshehta, të cilat përbëjnë veprë penale. (I tillë ka qënë dhe rasti i ngjarjes së 21 Janarit 2011, kur punonjësit e strukturave të Forcave Speciale, kanë tejkaluar kompetencat me dhunën e ushtruar qytetarëve, ndonëse protesta kishte përfunduar dhe për rrjedhojë, dhuna ishte e panevojshme).

*Së pari:* a) Gjatë apo pas kryerjes së operacioneve nga punonjësit e strukturave të Forcave Speciale Operacionale, mund të kryhen vrasje apo plagosje të personave të kërkuar apo kalimtarë të rastit, duke tejkaluar kompetencat, ose pa qënë në rastet e mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme.

Avokati i Popullit ka hetuar disa raste për keqtrajtime të shtetasve të ndryshëm nga punonjësit e Strukturave të Forcave Operacionale dhe si të tilla mund të përmëndim, ankesën e shtetasit Petrit Mahmutaj nga Patosi, Fatjon Diçi dhe Rena Thanasi nga Tirana, Altin Bejko nga Lazarati i Gjirokastrës etj.

b) Gjatë kryerjes së operacionit për kontrollin e personave apo mjediseve, nga punonjësit e forcave speciale të cilat realizohen pa praninë e personave të tjerë, ekzistojnë premisat për mundësinë e kryerjes së vjedhjes së vlerave materiale ose monetare,

c) Nga ana e drejtuesit të mjetit që transporton punonjësit e strukturave të Forcave Speciale Operacionale në destinacionin e caktuar para ose pas operacionit, mund të ndodhin aksidente automobilistike që përbëjnë veprën penale të *“Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”* me pasoja të rënda për jetën e qytetarëve.

Në këto raste, për të cilat hetimet fillojnë mbi bazën e kqyrjes së vëndit të ngjarjes, është organi procedues i cili do të kryejë të gjitha veprimet procedurale hetimore si, kqyrjen e vëndit të ngjarjes, të mjetit, sekuestrimin e sendeve prova materiale apo “arrestin në flagrancë” të personit sipas kritereve të përcaktuara në nenin 251 të Kodit të Procedurës Penale, marrjen e deklarimeve të personave që kanë dijeni për rrethanat të hetimit, etj. Këto veprime procedurale hetimore janë të domosdoshme për zbulimin e së vërtetës për ngjarjen dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorit të veprës penale, pavarësisht faktit se autori i veprës është punonjës i strukturave të Forcave Speciale Operacionale.

*Së dyti:* Në kreun e III-të të ligjit “Për Policinë e Shtetit, i cili bën fjalë për “Procedurat e brëndshme disiplinore” dhe konkretisht neni 74 e në vijim, bëhet fjalë për veprime ose mosveprime të punonjësve të policisë së shtetit të cilat vijnë në kundërshtim me Rregulloren e Disiplinës, e cila kur nuk përbën vepër penale ajo vlerësohet si shkelje disiplinore, për të cilën zhvillohet një proces disiplinor me masat përkatëse. Pra, ligji i mësipërm në këto raste nuk bën dallim për shkelësin e disiplinës, qoftë ai dhe punonjësi i strukturave të Forcave Speciale Operacionale. Kjo do të argumentonte dhe faktin se kur ky punonjës do të ishte subjekt i veprës penale ai do të jetë i barabarë para ligjit dhe ndaj tij do të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme hetimore.

Nga shqyrtimi i ankesave të shtetasve, apo dhe raste të tjera të filluara me Iniciativë, është konstatuar se punonjës të Komisariateve të Policisë të Ndërhyrjes së Shpejtë, Tiranë etj, në mbështetje të Komisariateve në rrethe, sidomos për rastet kur nga qytetarët kryhen “manifestime e grumbullime të paligjshme”, duke qënë me kapuç në fytyrë, kanë ushtruar dhunë fizike ndaj qytetarëve pjesëmarrës në to.

Veprime të tilla nga punonjës të këtyre Komisariateve janë shfaqur dhe në postbolloqet e ngritura nga Policia, edhe përgjatë rrugëve nacionale, veprime të cilat krijojnë situatë frike e pasigurie tek shtetasit. E përmëndëm këtë fakt pasi jo vetëm në ligjin organik për Policinë e Shtetit, por edhe në asnjë akt nënligjor nuk është parashikuar mbulimi i fytyrës me anë të vendosjes së kapuçit.

Opinionin mbarëshoqëror ka rritur pritshmërinë për faktin se shërbimet policore duhet t’i përshtaten parimeve të demokracisë, llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër etika policore dhe respektimi i standarteve profesionale, shërbejnë për të siguruar se dhënia e shërbimeve të policisë është e cilësisë më të lartë. Mendojmë se nuk mund të ketë pandëshkueshmëri policore për keqtrajtimet apo sjelljet e këqija nga punonjësit e policisë që i kryejnë ato, pavarësisht strukturave në të cilën ata bëjnë pjesë.

Prandaj, theksojmë se pika 3 e nenit 121 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i cili është pengesë për Prokurorinë si organi vetëm që ushtron ndjekjen penale, për realizimin e detyrave të saj kushtetuese dhe ligjore, duhet të përmirësohet dhe konkretisht:

Në pikën 3, të nenit 121, të shtohen gërmat me këtë përmbajtje: a) *“kur nga punonjësit e policisë së strukturave të Forcave Speciale Operacionale, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, para ose pas operacionit kryhen vepra penale, ndaj tyre ndiqen procedurat ligjore si për gjithë shtetasit e tjerë”.*

b) *“Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të venë në dispozicion të organeve të drejtësisë, personat dhe dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim kryerjen e hetimeve”.*

c) Prokuroria dhe Gjykata të zbatojë metodat dhe format ligjore të procedimit të cilat garantojnë sekretin e klasifikuar policor, të përcaktuar në nenin 14, të ligjit nr.8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor” si dhe fshehtësinë e identitetit të këtyre personave.

Në këto kushte dhe në bazë të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë Rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren se shkelja e të drejtave të lirive të njeriut nga*

*administrata publike”, si dhe nenit 24, gërma “a”, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, me ndryshimet përkatëse, i cili shprehet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është përmbajtja e ligjit ose akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura në Kushtetutë ose ligjet e tjera, ka të drejtë: t’u rekomandojë organeve që kanë të dejtën ligjvënëse, të bëjnë propozime për ndryshimin ose përmirësimin e ligjeve”,*

### **REKOMANDOJMË**

Marr0 jen e iniciativës ligjvënëse me grup deputetësh për përmirësimin pikës 3, të nenit 121, të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me ndryshimet përkatëse.

Lutemi për qëndrimin që do të mbani ndaj Rekomandimit të vihemi në dijeni.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**